# Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes

**1.1.2025 – 31.1.2025**

| Shkurtesa | Përshkrimi | Pranuar | Në proces | Miratuar | Refuzuar | Hedhur Poshtë | Pezulluar | Ceduar | Anuluar | Përfunduar | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| DA | Drejtoria e Administratës | 2 | 230 | 866 | 1 | 0 | 0 | 0 | 1 | 7,683 | 8,783 |
| DSH | Drejtoria e Shëndetësisë | 1 | 1,689 | 8 | 0 | 0 | 0 | 0 | 8 | 0 | 1,706 |
| DA | Drejtoria e Arsimit | 0 | 85 | 28 | 3 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 117 |
| DEZHL | Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm | 0 | 59 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 59 |
| DUNMM | Drejtoria e Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit | 0 | 180 | 17 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 198 |
| DIL | Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave | 0 | 72 | 10 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 82 |
| DSHPMSH | Drejtoria e Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpetimit | 0 | 407 | 68 | 16 | 0 | 0 | 0 | 7 | 0 | 498 |
| DK | Drejtoria e Kulturës | 0 | 34 | 2 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 37 |
| DI | Drejtoria e Inspeksionit | 0 | 92 | 7 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 99 |
| DF | Drejtoria e Financave | 0 | 219 | 686 | 16 | 0 | 0 | 0 | 2 | 0 | 923 |
| DK | Drejtoria e Kadastrit | 6 | 2,634 | 45 | 0 | 0 | 0 | 0 | 14 | 0 | 2,699 |
| DB | Drejtoria e Bujqësisë | 1 | 303 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 304 |
| KK | Kabineti i Kryetarit | 3 | 175 | 192 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 372 |
| DP | Drejtoria e Pronës | 0 | 23 | 2 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 25 |
| DMS | Drejtoria e Mirëqenies Sociale | 4 | 816 | 3 | 0 | 0 | 0 | 1 | 3 | 0 | 827 |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| DS | Drejtoria e Sportit | 0 | 85 | 1 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1 | 0 | 87 |
| DP | Drejtoria e Parqeve | 0 | 3 | 3 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 6 |
| DSE | Drejtoria e Sigurisë dhe Emergjencave | 0 | 13 | 5 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 18 |
| | | 17 | 7,119 | 1,943 | 39 | 0 | 0 | 1 | 38 | 7,683 | 16,840 |

## Sektori i gjendjes civile

### DOKUMENTET E LËSHUARA NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE - PËR PËRDORIM TË BRENDSHËM

| # | Komuna | Certifikatë e lindjes | Ekstrakt nga Regjistri qendror i Gjendjes Civile | Certifikatë e shtetësisë | Certifikatë e martesës | Certifikatë e vdekjes | Certifikatë e vendbanimit | Certifikatë e gjendjes martesore | Deklaratë e bashkësisë familjare | Vërtetim nga arkivi | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Prishtinë | 1178 | 1783 | 18 | 303 | 105 | 24 | 171 | 202 | 72 | 3856 |
| | **Gjithsej** | **1178** | **1783** | **18** | **303** | **105** | **24** | **171** | **202** | **72** | **3856** |

### DOKUMENTET E LËSHUARA NGA ZYRAT E GJENDJES CIVILE - PËR PËRDORIM TË JASHTËM

| # | Komuna | Certifikatë e lindjes | Ekstrakt nga Regjistri qendror i Gjendjes Civile | Certifikatë e shtetësisë | Certifikatë e martesës | Certifikatë e vdekjes | Certifikatë e vendbanimit | Certifikatë e gjendjes martesore | Deklaratë e bashkësisë familjare | Vërtetim nga arkivi | Gjithsej |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Prishtinë | 2425 | 3827 | 86 | 829 | 814 | 526 | 304 | 664 | 243 | 9718 |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Gjithsej** | **2425** | **3827** | **86** | **829** | **814** | **526** | **304** | **664** | **243** | **9718** |

Nga data **1.1.2025** e dri më **31.1.2025** nga Shërbimi i gejndjes civile janë lëshuar **13574** certifikata.

Raport i punës nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave që kanë të bëjnë me gjendjen civile, nga d**t. 1.1.2025 deri më 31.01.2025** në procedurë administrative nga ky komisioni janë nxjerrë **104 vendime** për kërkesat e palëve, të cilat kanë të bëjnë me çështje të ndryshme nga gjendja civile.

Gjatë kësaj peridhe, nga 1.1.2025 deri më 31.1.2025, janë lëshuar **51 dëshmi mbi vdekjen.**

**Raporti i adresave të ndërlidhura e të regjistruara në sisitem të gjendjes civile nga AKK janë 454, kurse nga E –Kosova janë 470.**

Shkëndije Krasniqi

U.d. e udhëheqëses së Shërbimit të gjendjes civile

## Sektori TI-së

| REZULTATET PËR MUAJIN Janar 2025 |
| --- |
| 1. **Ofrimi i shërbimeve:** mirëmbajtja e serverëve, mirëmbajtja e rrjetit lokal kompjuterik, shërbime harduerike dhe softuerike, mirëmbajtja e sistemit të menaxhimit të radhës, mirëmbajtja e-kiosqeve, përditësimi i informatave në ueb-faqen zyrtar "PrishtinaOnline", krijimi i llogarive në e-mail-in zyrtar;<br>2. **Menaxhimi/administrimi i projekteve dhe sistemeve:** administrimi i sistemit të brendshëm të Intranetit, mirëmbajtja e uebfaqes "PrishtinaOnline", komunikimi online me qytetarë përmes "PrishtinaOnline", platforma digjitale për participim publik;<br>3. **Ueb-faqe –** Publikimi i informatave të ndryshme, vendimeve të Kuvendit, procesverbalet e Kuvendit dhe KPF, vendimet e kryetarit, të hyrat, shpenzimet, buxheti, investimet, proceset e lëndëve të urbanizmit dhe legalizimit etj., vendosja dhe rregullimi i dokumenteve në ueb-faqen e re të Komunës të lansuar nga ASHI-ja.<br>4. **"HelpDesk":** për stafin e Komunës, si dhe për institucionet tjera komunale;<br>5. **Menaxhimi/mbikëqyrja dhe vlerësimi i kontratave:** menaxhimi i kontratës AQP-së: "Shfrytëzimi i fotokopjeve dhe printerëve me qira", menaxhimi i kontratës Mirëmbajtja dhe servisimi i pajisjeve të TI-së, Mirëmbajtja e e-kiosqeve, Mirëmbajtja e ueb-faqes "PrishtinaOnline" etj.;<br>6. **Përgatitja e konstatimeve për realizimin e pagesave për situacionet e projekteve të kontraktuara për sektorin e TI-së;**<br>7. **Bashkëpunim profesional me ekipin e Kabinetit të kryetarit për digjitalizim;**<br>8. **Takime javore për realizimin e projektit për TI në kuadër të projektit të USAID "Kontrata Sociale";**<br>9. **Transmetimi direkt i seancës së parë të Kuvendit të Kryeqytetit.** |

| SFIDA E MUAJIT JANAR 2025 |
| --- |
| 1. Kërkesat e shumta për furnizim me pajisje të TI-së, kërkesa të paplanifikuar paraprakisht nga ana e drejtorive dhe stafit komunal. |

**Sektori i bashkësive lokale**

**Raport mbi rezultatet e decentralizimit të shërbimeve komunale në bashkësitë locale (BL).**

**Përgatitur nga: Donat Abazi**
**Pozita: U.d. i udhëheqësit të Sektorit të bashkësive lokale**

# Hyrje

**Ky raport paraqet rezultatet e procesit të decentralizimit të shërbimeve komunale në zyrat e BL-ve në komunën e Prishtinës. Implementimi i këtij procesi ka synuar ofrimin më të shpejtë dhe më efikas të shërbimeve për qytetarët, duke reduktuar kohën e pritjes dhe duke sjellë administratën më afër komunitetit.**

# Rezultatet kryesore

## 1. Funksionalizimi i BL-ve

- **Janë funksionalizuar gjithsej 18 BL në lagje të ndryshme të Prishtinës;**
- **Këto zyra tashmë operojnë me staf të trajnuar dhe ofrojnë një gamë të gjerë shërbimesh për qytetarët.**

## 2. Rritja e numrit të shërbimeve

- **Para decentralizimit, shumë shërbime komunale ofroheshin ekskluzivisht në objektin kryesor të Komunës së Prishtinës.**

- **Tashmë një numër i konsiderueshëm shërbimesh janë në dispozicion edhe në zyrat e BL-ve, duke përfshirë:**
  - **Aplikimi për subvencione në Shëndetësi;**
  - **Aplikimi për subvencione në Mirëqenie Sociale.**
  - **Aplikimi për subvencione në Bujqësi (në 3 lokacione: Besi, Llukar dhe Taslixhe);**
  - **Pajisja me faturën e tatimit në prone;**
  - **Paisja me faturën e mbeturinave.**

## 3. Trajnimi dhe efikasiteti i stafit

- **Zyrtarët e BL-ve janë trajnuar për të ofruar shërbime në mënyrë efikase dhe profesionale;**
- **Efektiviteti i tyre është vlerësuar shumë pozitivisht nga qytetarët.**

## 4. Përmirësimi i përvojës së qytetarëve

- **Qytetarët kanë shprehur kënaqësi për shkak të:**
  - **reduktimit të pritjeve të gjata në sportelet e Komunës;**
  - **lehtësisë së marrjes së shërbimeve brenda lagjeve të tyre;**
  - **përmirësimit të qasjes në shërbime për të gjitha grupet shoqërore.**

## 5. Statistikat e shërbimeve të ofruara

- **Vërtetimet e vendbanimit: 3,305**
- **Subvencionet e Shëndetësisë: 1,276**
- **Subvencionet e Mirëqenies: 497**
- **Subvencionet e Bujqësisë: 213**
- **Fakturat e tatimit në pronë: 870**
- **Fakturat për mbeturina: 960**

## GJITHSEJ SHËRBIME: 7121

# Përfundime dhe rekomandime

- **Decentralizimi ka dhënë rezultate shumë pozitive dhe ka përmirësuar ndjeshëm shërbimet për qytetarët.**
- **Rekomandohet që procesi të vazhdojë, duke fuqizuar më tej bashkësitë locale, investime në pajisje teknologjike, meqë aktualet janë të vjetra dhe nuk mund të përditësohen dhe ndarja buxhetore për sanimin dhe ndërhyrjen e disa nga zyrave, si dhe furnizimin me invertar.**

# Sektori i logjistikës

| KOMUNA E PRISHTINES – SEKTORI I LOGJISTIKËS | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| **Nr.** | **Data:** | **Emri dhe mbiemri** | **Mirëmbajtja** | **Përshkrimi** | **Komentet** |
| | 1.1.2025 | Ekipi | | Festë | Objekti i vjetër i Komunës |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 2.1.2025 | | | Festë | |
| | 3.1.2025 | Ekipi | | Ekipa filloi shpërndarjen e ujit nëpër kate pas orës 08:30. Vizitë në objektin e ri të Komunës, lidhur me problemin që e kishim për rrjedhjen e ujit në banjë. Vizitova BL në Dardani, kishin problem me derën, për çka intervenoi ekipi, edhepse nuk kishte makinë zyrtare, e shfrytëzuan makinën private. | |
| | 4.1.2025 | Ekipi | | E shtune | |
| | 5.1.2025 | Ekipi | | E diele | |
| | 6.1.2025 | Ekipi | | Fillimisht kam bërë një vizitë **lidhur me pastrimin nëpër kate, por edhe jashtë objektit, ku konstatova se pastrimi ishte në nivelin e duhur. Ekipi ynë filloi demolimin e kaldasë në Taslixhe, ku hasi në telashe për shkak të madhësisë së kaldasë. Labinot Ymeri me një ekip ka shkuar në Bashkësinë Lokale në Llukar, për të bërë pastrimin e saj. Gjithashtu, sot u morëm edhe me çështjen e ujit në objektin e ri të Komunës. Bashkim Gashi e ka thirrur kipin, i cili e ka bërë renovimin më herët, për të vërtetuar se ku ka rrjedhje të ujit. Kam kontaktuar me inxhinjerin, Feridin, i cili e ka marrë për sipër ta vërtetoj se ku ka rrjedhë të ujit. Pastrimi i zyrave është bërë rregullisht.** | |
| | 8.12.2024 | Ekipi | | Me fillimin e punës vizitova objektin, i cili patsrohej nga shërbimet e pastrimit. Edhe objekti jashtë ishte duke u pastruar. Është bërë rregullimi i ujit në katin e katërt, rregullimi i dritave nëpër kate, bartja e ujit nëpër kate, si | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | dhe heqja e disa tavolinave dhe dollapëve në objektin e ri të Komunës. | |
| | 9.1.25 | Ekipi | | Vizitova katet në objektin e vjetër të Komunës dhe pjesën jashtë objektit, ku konstatova se gjithçka ishte në rregull. Së bashku me ekipin ishim në një vizitë në objektin e ri të Komunës. Për të parë ndarjen e zyrave te Drejtoria e Pronës. I dërgum materialet e kërkuara nga Drejtroria e Pronës. Janë marrë disa tavolina nga objekti i ri i Komunës dhe i kemi dërguar te Xhamia e Llapit, në zyrat e pensionistëve. Ekipi ka shkuar te Xhamia e Llapit në zyrat e pensionereve dhe i ka ndërrur drita edhe ne BL te Xhamia e Llapit. Ndryshimet në objektin e ri të Komunës i ka marrë përsipër Labinot Ymeri me kompani, si menaxher i kompanisë. | |
| | | | | Për çdo ndryshim dhe detyrat e kryera, do të njoftojmë me kohë. | |
| | 10.1.2025 | Ekipi | | Kontrolli lidhur me pastrimin brenda dhe jashtë objektit të vjetër të Komunës. Pjesa nga autoparku ka qenë e papastruar, edhe pse nuk e kanë në kontratë, në bisedë me Afrim Gashin, përgjegjës i komntratës, dhe në prezencën time, bisedoi me kompaninë dhe e morën për sipër që tash e tutje ta bëjnë pastrimin edhe ne pjesën e autoparkut. Sot filloi lirilmi i zyrës te hyrja, në katin përdhes, ku ka punuar Gani Dobratiqi, ku ekipi i Ganiut ka dalë në zyrën 409, kati i katërt, kurse zyra në katin përdhes është liruar për fillimin e renovimit. Eekipi sot ka kryer punë në BL te Xhamija e Llapitpit, janë | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | ndërrur dritat në BL, heqja e gomave nëpër shkallë, përgatitja e zyrës, bartja e karrigeve etj. | |
| | 11.1.2025 | Ekipi | | Ekipi është marrë me foltore, flamujt i ka dërguar në Prapashticë dhe i kanë kthyer në Komunë, në depo. Bashkim Gashi është marrë me prishjet në rrjetin elektrik. Të hënën në mëngjes kanë arritur me kryer problmemin e një faze të rrymës. Ka mbetur të dihet se kush mundet edhe pse, ku sipas tyre nuk ka kontratë askush. Kam biseduar me Bashkim Statovcin, me te nuk kemi kontratë, por është mebtur të kontaktojë me KEDS-in dhe të dihet se kush duhet ta ndërrojë një gyp të rrumës që e bartë rrjetin për një fazë. | |
| | 12.1.2025 | Ekipi | | | |
| | 13.1.2025 | Ekipi | | **Ekipi që në fillim është marrë me shpërndarje të ujit, kanë bartur karrige, i kanë dërguar në katin e dytë, zyra nr. 37, i kanë kthyer karriget aty ku i kanë marrë.**<br><br>**Në objektin e ri të Komunës, Bashkim Gashi është marrë me problemet e rymës, e ka bërë ndërrimin e një sigurese, Për të gjitha punët e kryera i kam dëshmi fotot.**<br><br>**Fadil Gashi nga kjo datë ka dalë të punojë në objektin e ri të Komunës deri më 20.1.2025. Më datën 20, në bashkëbisedim u pajtuam që ta dërgojmë një punëtor tjtër nga ekipi, Veton Islamin, Sylë Dobratiqin ose Labinot Ymeri, ashtu si të mrren vesh me rradhë nga një javë.** | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | **Sabri Islami në objektin e ri të Komunës, meret me bartjen e postës, ku e kam viztuar disa herë.** | |
| | 14.1.2025 | Ekipi | | Kontroll i zakonshëm për pastrimin e objektit të Komunës. Punëtorët punonin punët si zakonisht. Në Komunë ka pasur problem me rrjetin e energjisë elektrike, ku është rregulluar disa herë, por siguresat janë djegur. Labinot Ymeri ka dërguar siguresa shtesë, e në fund është thirrur kompania për të vërtetuar se ku është problemi. Në objektin e vjetër të Komunës janë kryer punë të cilat u janë caktuar, ku janë ndërruar drita aty ku ka pasur nevojë, si bartja e foltores në takim me Kryetarin në Pallatin e Rinisë, Salla e Kuqe, janë bartur librat dhe i kanë dërguar në Biblotekën, ku sot ka takim kryetari, biblotekës “Hivzi Sulejmani, janë bartur disa folderë dhe letra, me kërkesën e drejtorit të Kadastrit për nevojat e punës. Ekipi ka shkuar edhe në BL, në Lagjen e Muhaxhirëve , për rregullimin e nxehjes. Gjatë ditës janë rregulluar pajisje edhe në Drejtorinë e Inspeksionit. | |
| | 15.1.2025 | Ekipi | | **Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Për takimin e paraparë në orën 13:30. Pas takimit, flamujt do të barten në biblotekën “Hivzi Sulejmani”në Dardani. Është bërë përgatitja e sallës 37 për takim me delegacion që e ka pritur Kryetari, Përparim Rama.** | |
| | 16.1.2025 | Ekipi | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës, ku ka pastruar ekipi i kontraktuar në menaxhim të Afrim Gashit. Bashkim Gashi është duke u marrë | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | me problemin rrjetit energjetik në Komunën e re. Pas sigurimit të kabllos, pritet të eliminohet problemi. Me këtë problem është marrë edhe Bashkim Sadiku. Ekipi është marrë me shpërndarjen e ujit nëpër kate, bartjne ujit nga bufeja në katin e 2-të, nr 37, për takime. | |
| | 17.1.2025 | Ekipi | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Ekipi që në mëngjes ka bërë shpërndarjen e ujit në çdo kat. Ekipi në Komunën e re është duke u marrë me problemet e ujit dhe të rrymës. Problemi i rrymës besojmë se do të zgjidhet të shtunën dhe të dielën për ta ndërruar kabllon e rrymës. | |
| | 18.1.2025 | Ekipa | | Ekipi në Komunën e re është marrë me problemin e rrymës ditën e shtunë. | |
| | 19.1.2025 | | | Ekipi sot është marrë me problemin e rrymes dhe e ka ndërruar kabllon gjat kësaj dite, ku kemi ardhur në perfundim të problemit. Nga kjo datë ky problem me të cilin u morëm gati 2 javë, u hoq nga lista e problemeve të shpeshta. | |
| | 20 | | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. pastrimi ishte në nivel në objekt edhe jashtë objektit. Ekipi ka bërë furnizimin me uje në secilin kat. rregullimin e rrymës nëpër kate, rregullimi i 2 cilindrave në BL në Dardani. | |
| | | | | | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | 21.1.2025 | Ekipi | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Shpërndarja e ujit nëpër kate, rregullimi i rrymës në katin e parë te Sektori i Financave, lirimi i zyrës në katin e katërt, bartja e dokumentev, rregullimi i dritave në BL te Xhmia e Llapit, rregullimi i cilindrit në katin e tretë te BL Xhamia e Llapit, lirimi i zyrës, lirimi zyrës dhe bartja e dokumenteve nga zyra 414 dhe bartja e dokuneteve të cilat nuk kanë qenë për atë zyrë, rregullimi i gomave të shkallëve etj. | |
| | 22.01.25 | Ekipi | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës, gjithashtu edhe në objektin e ri të Komunës. | |
| | 23.01.25 | Ekipi | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Ekipi i mirëmbajtjes ka shkuar në BL në Hajvali për rregullimin e derës dhe ndërrimin e dy zyrave për të bartur inventarin nga zyra në zyrë. Ekipa sot është marrë me shpërndarjen e ujit nëpër kate. Ekipi në Komunën e re është duke i lëvizur disa inventarë në bazë të kërkesës së drejtorit të Kadastrit Vigan Kastrati. Kthimi i pishave nga e kipi, u janë dorëzuar atyre që i kanë pru për festën e Vitit të Ri ,Veton Islami, i ka kthyer dhe ngarkuar në kamion, rregullimi i derës në katin e tretë dhe dritav nga ekipa në Komunen e re. | |
| | 24.1.2025 | Ekipi | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Vizitë në Komunen e re, ku u takova me me ekipin | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | e mirëmbajtjes me punëtorin e postës dhe i shikova katet ku duhet të ndërrohen tabelat orienturese në kate. | |
| | 27.1.2025 | | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Me kërkesën e Kabinetit kemi shkuar te Kinemaja ABC, i kemi hapur dyert dhe ekipi janë marrë me rregullimin dhe ndërrimin e cilidnrave, janë ndërruar më shumë se katër cilimdra. Sylë Dobratiqi e ka marrë për detyrë nga 2 kopje të cilindrave me ia dhënë Andit të Kabinetit për me filluar punën në Kinema për procedura të mëtutjeshme, lirimin e parkingut, passtrimin e objektit për fillimin e punës lidhur me rregullimin. Ekipi sot ka bartur të gjitha tavolinat, mjetet e punës te drejtori Arbër Sadiku, është bërë ndërrimi i zyrave. Kam dalur me Taxi dhe kam bërë vizitë në Komunën e re, taxin e kam paguar 6 Euro me dalur dhe më ka prit me u kthyer. | |
| | 28.1.2025 | | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Ekipi me mëngjes ka bërë shpërndarjen e ujit nëper të gjitha katet, ekipi ka bërë rregullimin e disa ormanëve të vegjël në katin e dytë dhe katin e tretë. Ekipi ka bërë bartjen e printerëve, të cillët ishin jashtë përdorimit. I kanë dërguar në bodrum për me i vlerësuar TI se a janë për asgjësim. | |
| | 29.1.2025 | | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Ekipi ka shpërndarë ujin. Në objektin e ri të Komunës | |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | | | | është marrë me bartjen e tavolinave, kompjuterëve nga kati në kat. Sylë Dobratiqi ka bërë rregullimin e e dritave në kate dhe në disa vende edhe ndrrimin e tyre. Ekipi e ka marrë një orman dhe e ka dërguar në BL në Hajvali me makinen e Labinit Ymerit, makinë private, sepse ska vetura zyrtare ende. | |
| | 30.1.2025 | | | Ekipa me mengjes ka bërë shpërndarjen e ujit nëpër kate. Ekipi ka bërë pastrimin nëpër kate, është fjala për ekipin e pastrimit, ne objkt, kompania ka bërë pastrimin jashtë objektit në menaxhimin e Afrim Gashit. Ekipi ka shpërndarë ujin në Sallën e Kuvendit për takimin e Kryetarit me Policinë e Kosovës dhe zjarrfikës ekipi ka bërë rregullimin e dritave. | |
| | 31.01.25 | | | Kontrolli i zakonshëm lidhur me pastrimin e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të Komunës. Ekipi i pastrimit i ka pastruar të gjitha katet në perputhje me deyrat e tyre, ekipi i pastrimit jashtë e ka pastruar hyrjen e oborrit, ashtu si e kanë të kontraktuar në mbikëqyrje të Afrim Gashit, ekipi ka shpërndarë ujin nëpër kate, ekipi ka shkuar në bibliotekën "Hivzi Sulejmani" me rreegulluar banjën. Ekipi ka dalë në Komunën e re, ka bartur tavolina, kompjutera dhe të gjitha gjësendet për ndërrrimin e zyrave të punëtorëve të Kadastrit. Ekipi ka shkuar në bibliotekën "Hivzi Sulejmani" për të rregulluar banjën. | |

## Sektori i Kuvendit

**Raporti mujor i punës për punonjësit e këtij sektori:**

**1. Luljeta Selimi, udhëheqëse në Sektorin e Kuvendit**

Sektori i Kuvendit është organ profesional që kryen punë për Kuvendin e Kryeqytetit, ndihmon në mënyrë profesionale kryetarin, nënkryetarin dhe kryesuesin e Kuvendit lidhur me çështje profesionale juridike.

Roli i sektorit të Kuvendit i përket dhënies së shërbimit profesional për anëtarët e Kuvendit, komisioneve, komiteteve dhe trupave tjera të themeluar nga Kuvendi i Komunës. Është një zyrë profesionale, e cila për Kuvendin, komisionet, komitetet dhe trupat tjera të themeluara nga Kuvendi, kryen këto detyra:

Përgatit ftesën dhe rendin e ditës për mbledhje në aspektin teknik, gjuhësor, pas

pranimit të pikave të propozuara nga Kryetari dhe Kryesuesi për mbledhjet e radhës;

Ndihmon kryesuesin e Kuvendit që obligimet e dala nga seancat e Kuvendit për organet e

Administratës, të përgatiten dhe të dërgohen për ekzekutim;

Shpërndan materialin në mënyrë elektronike dhe fizike;

Mban procesverbal për mbledhje ose takime të komiteteve;

Harton transkriptin e mbledhjes së Kuvendit, ekstraktet e procesverbaleve të Kuvendit të Kryeqytetit, Komitetit për Komunitete, si dhe komiteteve të tjera;

Bën përkthimin e dokumenteve në gjuhë zyrtare shqip-serbisht dhe anasjelltas, lekturimin, si dhe arkivimin e tyre;

Bën përgatitjen e materialeve për mbledhjet e Kuvendit, pranon propozimet e rregulloreve, propozim-vendimet dhe materialet tjera për mbledhje të Kuvendit, përkatësisht në Komitetin për Politikë dhe Financa;

Përpilon tekstet e korrigjuara të miratuara në Kuvend, përpilon shkresa dhe materiale të Ndryshme, ku të njëjtat punë bëhen edhe në Komitetin për Politikë dhe Financa;

Bën hartimin e statuteve, vendimeve, rregulloreve dhe akteve tjera juridike, duke u kujdesur për teknikën e hartimit të tyre në bashkëpunim dhe konsultë me drejtorët e drejtorive;

Konstaton kuorumin e nevojshëm për fillimin e mbajtjes së mbledhjeve, si dhe bën numërimin e votave gjatë çdo procesi vendimmarrës;

Kujdeset që dërgimi i akteve të procedohet për shqyrtim të ligjshmërisë brenda afateve ligjore në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal;

Koordinon pyetjet dhe kërkesat shtesë nga anëtarët e Kuvendit, komitetit, komisionit apo trupave tjera të themeluara nga Kuvendi për kërkesat që janë objekt shqyrtimi.

Sektori i Kuvendit shërben edhe si zyrë profesionale ndërlidhëse me ekzekutivin e Komunës, qytetarët dhe palët tjera të interesuara për kërkesa që adresohen në Kuvend, komitete, komisione apo trupa tjera të themeluara nga Kuvendi.

Gjatë muajit janar 2025, kemi pranuar të gjitha propozimet dhe materialet e tjera lidhur me plotësim-ndryshimet shtesë nga drejtorit përkatëse, lidhur me pikat e propozuara për mbledhjen e radhës të Komitetit për Politikë dhe Financa si dhe Kuvendit.

Gjatë muajit janar 2025, janë kryer edhe punë të tjera:

Përgatitja e materialeve, rendit të ditës dhe pjesëmarrja në mbledhje e parë të KPF-së;
Hartimi dhe përgatitja e marterialeve për mbledhjen e parë të Kuvendit të Kryeqytetit;
Fillimi i hartimit të ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e parë e Komitetit për Politikë dhe Financa;
Hartimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit të Kryeqytetit;
Pjesëmarrja në mbledhjen e parë të Kuvendit të Kryeqytetit, mbajtur më 31.1.2025, si dhe mbajtja e procesverbalit;

Hartimi i ekstraktit të procesverbalit të Komitetit për Komunitete, përgatitja e materialit për mbledhjen e Komitetit për Komunitete, pjesëmarrja në mbledhjen e Komitetit për Komunitete, si dhe mbajtja e procesverbalit;

**Gjatë muajit janar 2025, janë lektoruar këto materiale:**

Urdhëresë që pajisja me inventar të bëhet përmes sistemit E-pasuria; Vendim për vënie në diskutim publik të Strategjisë për Prishtinën, për artin dhe kulturën 2026-2031; Arsyetim i Vendimit për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm “Çagllavicë” në Prishtinë; Ekstrakt nga takimi kundër dhunës në familje, mbajtur më 9.9.2024; Strategjia e Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031; Lekturim i projekt-raportit të auditimit të brendshëm; Lekturim i ekstraktit të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 17.1.2025; Thirrje për mbledhjen e Komitetit për Komunitete; Thirrje për mbledhjen e parë të Kuvendit 2025; Vendim për miratimin e kërkesës së përfaqësuesve të lagjes “Kodra e Diellit II” për themelimin e Komisionit për vlerësimin dhe shqyrtimin e Aktvendimit mbi eksproprijim, nr. 7. nr. 465-25/85, të datës 8 korrik 1985; Lekturimi i Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinë;Plani gjithëpërfshirës i Komunës së Prishtinës, janar – dhjetor 202; Lekturimi i Propozim-vendimit për familjet strehuese dhe fëmijtë në strehim në familje; Arsyetimi i Vendimit për fillimin e revidimit të PRRH “Zona Ekonomike” në Prishtinë; Raporti vjetor i Kuvendit, 2024; Propozimi për ndarjen e mjeteve për shërim; Njoftim i Sindikatës së Komunës së Prishtinës, për shënimin e përvjetorit të Pavarësisë së Kosovës, më 17.2.2025; Lekturimi i Planit të punës për buxhet dhe finnca për vitin 2025; Lekturim i ekstraktit të mbledhjese së njëmbëdhjetë të KPF-së, më 13.12.2024; Lekturimi i raportit vjetor të punës, janar – dhejtor 2024; Lekturimi i propozim-vendimit për përkrahje financiare për familjet strehuese dhe fëmijët në strehim familjar; Lekturimi i propozim-vendimit për caktimin e lokacionit për ndërtimin e institucionit parashkollor dhe caktimi i lokacionit për ndërtimin e objektit të kultit-xhamisë në fshatin

Orlloviq, të komunës së Prishtinës; Lekturimi i propozim-vendimit për fillimin e revidimit të Planit rregullues të hollësishëm Zona Ekonomike në Prishtinë; Lekturimi i propozim-vendimit për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm "Çagllavica" në Prishtinë; Lekturimi i Planit të veprimit.

**Gjatë muajit janar 2025, janë përkthyer këto materiale:**

L.5524-24- kadastër, L/7646-24- kadastër, Ekstrakti i procesverbalit ZKKK; Konkurs -Drejtoria e Kulturës, L.2025001-Kadastër, raporti i muajt dhjetor ZKKK, L-7781-Kadster;

Konkurs -Drejtoria e Kulturës, L.7393-b24-Kadastër, L. Avdyl Zhitija- Kadastër L.7395-b24-Kadastër; **Përkthim Simultan,** Mbledhja e Komitetit për Komunitete; L-4255-b24-kadasër, aktemërimi, formulari i vlerësimit, adoptimi i kafshës; Kërkesa për adoptim, L. Xhafer Jakupi – Kadastër, adapto qen, Rregullorja për zhurmë akustike, L.83714-b 24 –Kadastër, L.4086-b24- Kadastër; L.09-030-01 D. Inspekcionit, Ekstrakti i ZKKK, L-8359-b-24 –Kadastër.

Gjatë muajit janar 2025, janë kryer edhe punë të tjera, varësisht nga kërkesat e parashtruara.

## Sektori i Autoparkut

| Nr | **Lloji i Automjeteve** | km kalura | **Benzinë** | **NAFTË** | **%100 k v. euro** | **vlera euro** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Xhip Tojota 01Z-65-19, Kryetarit | 853 | | 111.01 | 13.01 | 135.66 |
| 2 | SHKODA 01Z-19-19, KRYETARIT | 1191 | | 61.33 | 5.14 | 74.95 |
| 3 | XHIP NISSAN 01Z-11-19 NENKRYETARJA | 644 | | 107.55 | 16.70 | 131.44 |
| 4 | XHIP NISSAN 01Z-12-19 D.ISPEKSIONIT | 951 | | 147.00 | 15.45 | 179.65 |
| 5 | HYUNDAI 01Z-24-19 Shoqata e të Verbërve | Sh.verb.PR | 39.69 | | | 46.82 |